

Republika e Maqedonisë dhe UE-ja: Riziku i status quos- së

EPI e publikon këtë komentim menjëherë pas shpalljes së Strategjisë për zgjerim dhe raportet e progresit të shteteve të Ballkanit Perëndimor në procesin e anëtarësimit në UE nga ana e Komisionit Evropian me 12 tetor 2011, pas reaksioneve të para në Republikën e Maqedonisë me rastin e Raportit.

Megjithatë, risi ne "Ballkanin Perëndimor"

Dy shtete nga rajoni ballafaqohen me zhvillime thelbësore - Mali i Zi, me marrjen e rekomandimit për filimin e negociatave dhe Serbia, me statusin e propozuar të shtetit kandidat dhe klauzules shtesë për mundësinë e hapjes së negociatave varrësisht nga normalizimi i marrëdhënieve me Kosovën.

Kroacia - dikur shteti i dytë në procesin e stabilizimit dhe asociimit - është duke e përfunduar procesin e anëtarësimit.

Status quo - ja mbetet për vendet tjera të rajonit, përfshirë Republikën e Maqedonisë, për të cilën vazhdon vlejë rekomandimi për hapjen e negociatave.

Në një kohë të vështirë në Unionin Evropian në procesin e vendimmarrjes për zgjerim, me paketen e këtij viti Komisioni Evropian arriti të sigurojë kredibilitet për procesin. Koha dhe mënyra e përcaktimit të rendit të ditës dhe dimensionimi i shpërblimeve dhe sanksioneve, të cilat kanë qenë gjithmonë në duart e UE-së, bëhen instrumente edhe më të fuqishme edhe në këtë valë të zgjerimit. Në përpjekjet për të ruajtur ndikimin në rajon, njëkohësisht duke adresuar shqetësimin e shteteve anëtare për një zgjerim të ardhshëm me kandidatë të "papërgatitur", KE përgjigjet me elemente të reja në Strategjinë për zgjerim.

Kështu, me Strategjinë e këtij viti kriteret politike në masë të madhe integrohen në negociatat. Gjatë negociatave kaptinat e para që do të hapen dhe mbyllen janë kaptina 23 - Gjygjësori dhe të drejtat fundamentale dhe kaptina 24 - Drejtësia, Liria dhe Siguria, të cilat vazhdimisht do të monitorohen përmes planeve konkrete akcionale¹. Kriteret politike gjithnjë e më tepër bëhen "katalizator i negociatave". Pralajmërohet intensifikim i mëtejshëm i dialogut për sundimin e së drejtës, që do të thotë "prioritet i vazhdueshëm i reformës së gjygjësorit dhe administratës publike, luftës kundër kimit të organizuar dhe korrupsionit"². Përveç kësaj, liria e mediave është identifikuar si problem serioz në mbarë rajonin.³

Me këtë qasje rritet dhe më tej ndikimi i EK-së dhe shteteve anëtare mbi reformat politike në shtetet candidate. Pavarësisht rritjes së acquis në këto fusha, sfida vazhdon të paraqesë menaxhimi me reformat, ku në bëjnë pjesë praksat e mira. Fokusi shtesë mbi administratën publike, e cila në thelb është në kompetencat e shteteve anëtare, bart me vete sfidat për të siguruar parimet e bashkëpunimit

¹ Komisioni Evropian, Bruksel, 12.10.2011, COM(2011) 666 fund, Komentimi e Komisionit për Keshillin dhe Parlamentin evropian - Strategjia për zgjerim dhe sfidat kryesore 2011 - 2012, fq.23

² Ibid.

³ Ibid fq.6

dhe objektivat e politikave te përbashkëta të UE-se, dhe shmangjen e transplantimeve jokritike të zgjedhjeve të papërshtatshme.

Mbetet e paqartë se deri në çfarë mase UE-ja do ta mbaje ndikimin në reformat në rajon, perderisa stimuli kryesor - anëtaresimi në UE - është i pacaktuar dhe njëkohesisht dominojnë kriteret të cilat nuk dalin nga kriteret e Kopenhagës, por janë eksternalie të interesave të shteteve ekzistuese anëtare. Nga ana tjetër, sukcesi i forcave të brendshme politike në shtetet në procesin e zgjerimit do të matet me gatitshmërinë e tyre për të rradhitur përfitimet afatshkurta politike dhe për të arritur një vizion të përbashkët për të ardhmen e shteteve dhe rajonit.

Republika e Maqedonise: Rekomandimi mbetet, por mesazhi paralajmeron

Raporti vazhdon ta theksojë të njetin vlerësimin kyc si në dy raportet e mëpareshme, së Republika e Maqedonisë " në masë të mjaftueshme i plotëson kriteret politike"⁴.

Nëse në vitin 2009 u konstatua se kishte "përparim thelbesorë" në vitin 2010 është vlerësuar se ka " përparim të mëtejshëm, por me tempo jokonstante"⁵. Ketë vit janë konstatuar " sfida te konsiderueshme".⁶ Ata hasen ne zbatimin e legjislacionit të mirratuar, larine e mediave, pavarësine e gjyqësorit, reformën në administratën publike, luftën kunder korrupsionit.

"Meritat" për mbajtjen e rekomandimit për anëtaresim, sigurisht i përkasin zgjedhjeve dhe formimit efikas të qeverisë së re. Por, edhe vlerësimi i mirë për zgjedhjet u hijëzua nga konstatimi i forte i marrë nga OSBE se ekzistojnë " pohime te bazuara për ndarrjen e pamjaftueshme të shtetit dhe partisë, si dhe presioni mbi nënpunesit civil"⁷.

Krahasimi i vlerësimeve në raportet në pjesen e kriterëve politike, nga marrja e rekomandimit për fillimin e negociatave - për periudhën 2009 - 2011 - tregon se ka ulje te konsiderueshme të progresit në vitin 2010 krahasuar me vitin 2009, përderisa në vitin 2011 vlerësimet janë shumë të përaferta me ato të vitit 2010 (Shtojca 1: Tabela 1)⁸

Shkurtimisht, statusi dhe vlerësimet për progresin mund të përshkruhen si status quo. Megjithatë, problemi qëndron në faktin se mbajtja e një status quo-je të tillë do të thotë regres. Pse? Progresi i ulët u referohet fushave të cilat paraqesin benchmark për fillimin e negociatave - dialogu politik, gjyqësori, administrata publike, lufta kundër korrupsionit. Benchmark -qet në masë të madhe kanë të bejnë me sundimin e së drejtës - fushë prioritare vecanerisht në këtë Strategji për zgjerim, të ciles jo vetem KE-ja por edhe shtetet anëtare i kushtojnë kujdes të posacëm. përvec kesaj, situata me lirine e mediave është vlerësuar si fusha deri tani më kritike.

Edhe për kriterin e dytë të Kopenhagës – atë ekonomik - mbetet vlerësimi i vitit 2009 - se Republika e Maqedonisë është " shumë e avancuar në plotësimin e kriterëve ekonomike"⁹. Megjithatë, vlerësim për

⁴ Ibid.fq.26

⁵ Komisioni Evropian, Bruksel, 9.11.2010 (COM (2010) 660), Komentim i Komisionit per Keshillin dhe Parlamentin evropian - Strategjia per zgjerim dhe sfidat kryesore 2010 - 2011, fq.35

⁶ Komisioni Evropian, Bruksel, 9.11.2010 (COM (2010) 660), Komentim i Komisionit per Keshillin dhe Parlamentin evropian - Strategjia per zgjerim dhe sfidat kryesore 2011-2012, fq. 26.

⁷ Komisioni Evropian, Bruksel, 12.10.2011 SEC(2011) 1203, Dokument pune i Komisionit, Republika e Maqedonise, fq.7.

⁸ Shprehjet e unifikuarara qe KE përdor në raportet vjetore për të vlerësuar progresin (në konkluzionet e çdo fushe) mundesojne kuantifikim dhe krahasim. Sipas metodologjisë tonë, shprehjet janë të kuantifikuara në këtë mënyrë: 0: Nuk ka progres; 1. Pak progres / fillestare / i kufizuar, 2. Modeste / pjesshme / ca progres, 3. Progresi / progres i mëtejshëm; 4. Mirë / i dukshem / progres i qëndrueshëm; 5. Progres signifikant / thelbesor / i rëndësishem.

⁹ Komisioni Evropian, Bruksel, 9.11.2010 (COM (2010) 666), Komentim i Komisionit per Keshillin dhe Parlamentin evropian - Strategjia per zgjerim dhe sfidat kryesore 2011-2012, fq. 40.

përmbushjen e tyre nuk ka. Sërish pengesa për një ekonomi funksionale të tregut haset në sundimin e së drejtës - administrata publike joefikase, shumë ndryshime administrative, mungesa e pavarësisë e disa trupave rregulatorë dhe mbikqyrës.¹⁰

Sa i përket kriterit të trete të Kopenhagës - përmbushjes së obligimeve për anëtarësim ose të famshmes *acquis communautaire*, vlerësimi i progresit këtë vit është me i madh në krahasim me vitin e kaluar, por i parëndësishem. (Shtojca 2, Figura 1)¹¹. Vlerësimi për hamonizimin me *acquis* rritet gradualisht (shtojca 2, figura 2)¹². Por ajo që është thelbësore edhe për këtë kriter është konstatimi se edhe përkrah harmonizimit formal - sjelljes së ligjeve dhe akteve nënligjore, zbatimi i ligjeve mbetet problem¹³. Kjo përseri tregon problem thelbësor me sundimin e së drejtës.

Përgjigja e pamjaftueshme e qeverisë për problemet e caktuara vitin e kaluar rezulton në tone kryesisht më kritike për Republikën e Maqedonisë, sic theksohet qartë në deklaratën e Komisionit për zgjerim Stefan File se ka "progres të vogël"¹⁴. Ky vlerësim pritej, nëse merret parasysh logjika e zgjërimeve të deritanishme - çdo problem i pazgjidhur, theksohet edhe më tepër vitin e ardhshëm. Kjo gjithashtu nuk paraqet surprizë, për shkak të dialogut të vazhdueshëm mes Qeverisë dhe Brukselit.

Në vend të veprimit të pershtatshëm, reagim i papërshtatshëm

Fakt është se me këtë lloj status quo-je, procesi i anëtarësimit në UE ka gjithnjë e më pak ndikim në reformat e brendshme në Republikën e Maqedonisë. Së për këtë është e vetëdijshme edhe vete EK, tregon qëndrimi se "lëvizja e procesit të anëtarësimit të Republikës së Maqedonisë në periudhën e ardhshme do të kishte qenë e dobishme për impulsin për reforma dhe klimën e marrëdhënieve ndëretnike, dhe do të ndikonte pozitivisht në rajon"¹⁵.

Megjithatë, ajo që është më shqetësuese së vetë raporti është reaksioni i qeverisë së Republikës së Maqedonisë menjëherë pas raportit. Përkrah deklaratave të balancuara të Zëvendës Kryeministres Arifi për raport pozitiv "i cili e pasqyron realitetin tonë"¹⁶, dhe deklaratës zyrtare të Ministrisë së Punëve të Jashtme¹⁷, Kryeministri i drejton kritika të ashpra komesarit File për "vërejtjet e tejtheksuara"¹⁸ për gjyqësorin, administratën publike dhe lirinë e mediave. Pikëpamjet e këtylla të ndryshme për raportin madje edhe brenda koalicionit qeveritar, vecanërisht pas dështimit të regjistrimit të popullatës, nuk paraqesin bazë për qasje konsensuale e cila është e domosdoshme në një periudhë kritike për integrimin e Republikës së Maqedonisë në UE.

¹⁰ Ibid.fq 41

¹¹ Vlerësimet e përgjithshme nuk janë një mesatare aritmetike e kaptinave, por janë të matura në bazë të gjerësisë të *acqui* edhe kompleksitetit të kaptinave të ndryshme

¹² Në këto kriter, përkrah vlerësimeve të progresit që nga viti i kaluar, KEja jep një pasqyrim të nivelit të përgjithshëm të harmonizimit me *acquis*, të cilin e kuantifikojmë në mënyrën vijuese 0 - E pa filluar; 1 - faza e hershme / faza shumë e hershme / faza fillestare, 2 Jo-shumë e avancuar / avancimin i ngadalshëm / duke avuar; 3 - avancim modest; 4 - i avancuar / në një fazë të avancuar; 5 - shumë të avancuar. duhet të merret parasysh se ky kuantifikim nuk mund të jetë plotësisht i sakt, si progresi sepse niveli dhe harmonizimi i kaptinave ndryshojnë

¹³ Komisioni Evropian, Bruksel, 9.11.2010 (COM (2010) 666), Komentimi i Komisionit për Këshillin dhe Parlamentin evropian - Strategjia për zgjerim dhe sfidat kyesore 2011-2012, fq. 41..

¹⁴ Fjalimi i Komisionit për zgjerim Stefan File në Pres Konferencën me rastin e publikimit të Paketit për zgjerim, 12.10.2012 http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2011/package/fule_speech_12_oct_2011_en.pdf

¹⁵ Komisioni Evropian, Bruksel, 9.11.2010 (COM (2010) 666), Komentimi i Komisionit për Këshillin dhe Parlamentin evropian - Strategjia për zgjerim dhe sfidat kyesore 2011-2012, fq. 14

¹⁶ Deklarata e Zëvendës kryeministres të Republikës së Maqedonisë Z. Teuta Arifi pas publikimit të Raportit për progresin të KE 2011 (sipas MIA, 12.10.2011, Arifi: Raporti është pozitiv, negociatat akoma janë të kufizuara me zgjedhjen e cështjes së emrit, <http://www.mia.com.mk/default.aspx?vld=87853364&lld=1>)

¹⁷ <http://mfa.gov.mk/default1.aspx?ItemID=318&id=1356>

¹⁸ Deklarata e Kryeministrit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë z. Nikolla Gruevski pas publikimit të Raportit për progresin të KE 2011 (sipas MIA, 12.10.2011, gruevski: përkrah bllokadave për shkak të cështjes së emrit, jemi duke vazhduar me reformat dhe integrimin evropian <http://www.mia.com.mk/default.aspx?vld=87554357&lld=1>)

Menjëherë pas Raportit, ballafaqohemi me një situatë e cila në vend të një veprimi të përshtatshëm ka një reagim të papërshtatshëm.

Hasim në dy teza kundërthënëse: e para - së vlerësimet në Raportin janë te ulta me qëllim që të rritet presioni për zgjidhjen e çështjes së emrit dhe e dyta se fillimi i negociatave do të ndihmojë sigurimin e kohezionit të brendshëm të reformave.

Në këtë rreth, Republika e Maqedonisë është në rrezik të humbjes së pozicioneve në dy fronte - në çështjen e emrit dhe demokratizimit të shtetit. Demokratizimi, duke përfshirë kulturën e dialogut është ajo që Republikës së Maqedonisë i jep kredibilitet në betejën legjitime për emrin.

Në këtë situatë Republika e Maqedonisë nuk mund të tolerojë që dhe më tutje ti humb aleatët.


Së fundi, ishte KE i cili rekomandoi fillim të negociatave në vitin 2009 dhe status të shtetit kandidat në vitin 2005, për të cilin vendosën unanimisht shtetet anëtare të UE-së.

Tabela 1: Vlerësimet për progresin në fushat e kriterëve politike në raportet e KE në periudhën 2009 - 2011


	2009		2010		2011	
1.1. Demokracia dhe sundimi i se drejtes:						
Implementimi i Marreveshjes se Ohrit	Progres	3	Progres i caktuar	2	Progres i caktuar	2
Zgjedhjet	Permbushje e pjeses se madhe te standardeve nderkombetare	3			Permbushje e pjeses se madhe te standardeve nderkombetare	3
Dialogu politik	Progres i mire	4	Progres i caktuar	2	Progres i caktuar	2
Parlamenti	Progres i mire	4	Progres i metejshe	3	Progres i caktuar	2
Ekzekutivi	Koalicion stabil qeveritar, funksionim efikas	4	Koalicion stabil efikas, tejkalmi i dallimeve permes bashkepunimit	3	Dallimet e tejkaluara, bashkepunimi i forcuar	3
Administrata publike	Progres i caktuar	2	Progres i caktuar	2	Progres i kufizuar; progres i kufizuar ne zbatim	2
Gjygesori	Progres i metejshe	3	Progres i kufizuar	1	Progres i kufizuar	1
Lufta kunder korrupsionit	Progres i mire	4	Progres i caktuar	2	Progres i kufizuar	1
1.2. Te drejtat e njeriut dhe mbrojtja e pakicave	Ekziston kornize ligjore dhe institucionale, progres i kufizuar ne respektimin dhe avancimin e te drejtave te njeriut права	1	Ekziston kornize ligjore dhe institucionale, progres i kufizuar ne zbatimin dhe avancimin e te drejtave te njeriut права	1	Ekziston kornize ligjore dhe institucionale, progres i kufizuar ne zbatimin dhe avancimin e te drejtave te njeriut права	1

	2009		2010		2011	
Te drejtat civile dhe politike	Hapa te caktuara, e avancuar ne shkalle te moderuar	2	Te drejtat civile dhe politike gjenaralisht respektohen, progres I kufizuar	1	Progres I caktuar	1
Te drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore	Hapa te caktuara, pjeserisht I permbush prioritetet	2	Sigurim I te drejtave ekonomike dhe sociale por progres I kufizuar	1	Sigurim I te drejtave ekonomike dhe sociale por progres I kufizuar	2
Te drejtat e pakicave, mbrojta e pakicave dhe te trashegimive kulturore	Progres I caktuar	2	progres	3	Progres I caktuar	2
1.3. Ceshtje rajonale dhe obligime nderkombetare	Pjesemarrje aktive rajonale, zhvillon bashkepunim bilateral, ceshtja e emrit ndikon ne raportet me Greqine		Pjesemarrje aktive rajonale, zhvillon bashkepunim bilateral, ceshtja e emrit ndikon ne raportet me Greqine		Partner konstruktiv ne rajonm ngrit marredhenie bilaterale, ceshtja e emrit vazhdon te ndikoje ne raportet me Greqine	
Vleresimi I pergjithshem	Ne mase te mjaftueshm e I permbush kriteret politike		Vazhdon ti permbush kriteret politike ne mase ne mjaftueshme		Vazhdon ti permbush kriteret politike ne mase ne mjaftueshme	

Grafikoni 1



Grafikoni 2:



Progres dhe harmonizim sipas kaptinave te *acquis* per periudhen 2009-2011

Kaptina	progres			Shkalla e harmonizimit		
	2009 r.	2010 r.	2011 r.	2009 r.	2010 r.	2011 r.
1. Liria e levizjes se mallerave	2	4	2	2	3	3
2. Liria e levizjes se punetoreve	2	1	1	1	1	1
3. E drejta e formimit dhe e dhenies se sherbimeve	2	2	3	1	2	1
4. Liria e levizjes se kapitalit	2	3	2	2	2	3
5. Prokurimi publik	4	3	3	4	3	5
6. E drejta tregetare	4	4	4	3	3	3
7. E drejta e pronesisë industrial	2	2	2	3	3	3
8. Politika e konkuresces	2	2	2	3	3	3
9. Sherbimet financiare	2	4	4	3	3	3
10. Shoqeria informative dhe mediumet	3	3	3	3	3	3
11. Bujqesia dhe zhvillimi rural	3	3	3	1	2	3
12. Siguria e prodhimeve ushqimore, politika veterinare dhe fitosanitare	2	2	4	2	2	4
13. Peshkataria	2	2	2	2	2	3
14. Politika e komunikacionit	4	2	3	4	4	4
15. Energjetika	2	2	4	2	3	3
16. tatimet	4	1	1	3	3	3
17. Politika ekonomike dhe monetare	2	1	5	3	2	4
18. Statistika	4	4	4	4	4	4
19. Politika sociale dhe punesimi	1	1	1	3	1	2
20. Shoqerite dhe politika industriale	3	2	3	3	3	3
21. Mrezhat trans-evropiane	3	2	3	4	3	4
22. politika rajonale dhe elementet stukturore	2	2	2	3	3	3
23. Gjygesori dhe te drejtat fundamentale	3	1	1	3	3	3
24. Drejtësia, liria dhe siguria	4	3	3	4	4	4
25. Shkence dhe hulumtim	2	2	3	4	3	2
26. Edukimi dhe kultura	2	2	2	4	3	3
27. Mjedisi jetesor	3	3	2	3	3	3
28. Mbrojtja e konsumatoreve dhe shendetiti publik	2	2	2	3	2	3
29. Unioni doganor	5	2	4	4,5	4,5	4
30. Marredheniet e jashtme	2	3	3	4	4	4
31. Politika e jashtme, e siguresë dhe mbrojtjes	2	4	4	4	5	5
32. Kontrolli financiar	2	2	1	2	2	2
33. Dispozitat financiare dhe buxhetore	2	2	1	3	3	3